

6 Përcaktori

Përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë me lidhje të përshtatjes dhe drejtimi e bashkimi, që vihet në marrëdhënie përcaktore me gjymtyrën prej së cilës varet: u përgjigjet pyetjeve *ç'?*, *i, e kujt?*, *sa?* Përcaktori mund të hiqet pa e prishur strukturën e fjalisë, kurse fjala përcaktuese jo. Kjo e dyta është element i domosdoshëm strukturor: Kjo vepër *e shquar* i solli freski letërsisë së Rilindjes. Tullat *e reja* po i ngjithnin me vinç deri në katin *e pestë*.

Sipas lidhjes sintaksore dallohen:

1. **përcaktori me përshtatje:** Lulet *shumëngjyreshe të ndriçuara* nga dielli lëshonin aromë *të këndshme*.
2. **përcaktori me drejtim:** Pjesëmarrësit *e olimpiadës* u mblodhën në sallën e madhe.
3. **përcaktori me bashkim:** Kishte dalë *tërë* fshati. Kodra *përballë* ka plot ullinj. Kaluan dy njerëz *hipur mbi kuaj*. I ra përçark kopshtit *rrethuar* me një gardh kumbullash.
4. **ndajshtimi** (përcaktor me përshtatje të pjeseshme).

Ndajshtimi

Ndajshtimi është një lloj përcaktori i shprehur me emër të pashquar që sqaron më mirë kuptimin e gjymtyrës prej së cilës varet. Ndajshtimi përshtatet me këtë gjymtyrë në numër dhe kjo përshtatje jo e plotë e dallon atë si një lloj i veçantë përcaktori. Ndajshtimi përcakton një emër a përemër vetor: *Profesor Xhuvani* ka dhënë një ndihmesë tepër të çmuar për gjuhësinë shqiptare. Lumi *Shkumbin* përshkon një luginë mjaft piktoreske. Për ju *studentët*, këto janë çaste të paharrueshme.

Përcaktori kallëzuesor

Përcaktori kallëzuesor është gjymtyrë e dytë e fjalisë që ka lidhje të dyanshme: vihet në marrëdhënie rrethore me foljen në funksionin e kallëzuesit ose të një gjymtyrë të dytë dhe në marrëdhënie përcaktore me një emër në funksionin e kryefjalës ose të kundërnorit. Tekniku e gjeti tubin të bllokuar.

Dallohen:

- Përcaktori kallëzuesor pranë një foljeje: Atdheu ynë patjetër që do të bëhet *më i bukur*.
- Përcaktori kallëzuesor pranë një mbiemri foljor është mjaft i rrallë. Shtëpinë e bërë *gërmadhë* do ta ndërtonin. E donte shumë atë djalë të rritur *jetim, me halle*.
- Përcaktori kallëzuesor pranë një mbiemri foljor: Shpallja e Petritit “*mësues i merituar*” u prit me duartrokitje.

- Ai e kishte bërë politikën *tregti*.

Gjymtyrë të tjera të dyta

Gjymtyra e shtimit – shënon sendin a qenien që i shtohet një sendi a qenie tjetër të shprehura në fjali si gjymtyrë të shtimit.

Shtëpia ka tri dhoma, *përveç odës së zjarrit*.

Njerëzit, *krahas punës*, mendonin edhe për gëzimet e tyre.

Gjymtyra e përjashtimit-shpreh përjashtim a kufizim të një pjesë të tërësisë që nuk përfshihet në pohimin as mohimin e shprehur në fjali.

Ai nuk është marrë me asgjë, *përveçse me mendimet e tij*.

Afrimi, *veç emrit të tij*, asnjë fjalë tjetër nuk kishte nxjerrë.

Gjymtyra e kundrisë (e kundërvënies)-kjo gjymtyrë qëndron në raporte kundërshtore me gjymtyrë të tjera në fjali.

Në vend të tij, u përgjegj, shpotitës, Pandeli Sotiri.

Gjymtyra e spikatjes (theksuese)-Me këtë gjymtyrë tërhiqet vëmendja më shumë te një gjymtyrë tjetër, sidomos te kryefjala e fjalisë.

Sa për Afrimin, ai vërtet nuk ka munguar asnjëherë.

Për të punuar, ai ka punuar mirë.

Gjymtyrët homogjene

Gjymtyrë homogjene quhen ato gjymtyrë që përmbushin të njëjtat funksione sintaksore dhe janë në raporte kuptimore bashkërenditjeje midis tyre dhe me lidhje bashkërenditëse dhe asindetike.P.sh.

Unë i kam dashur, i dua dhe i respektoj shumë muratorët dhe punonjësit.

Mësimi dhe puna, shkolla dhe jeta duhet të lidhen ngushtë që në moshë të re.

Do të nisemi, ja me Petritin, ja me Skënderin.

Gjymtyrë të veçuara janë gjymtyrët e dyta që karakterizohen me veçori kuptimore, stilistike e intonacionore, duke pasur në fjali një mëvetësi relativisht të madhe.P.sh.

Pastaj ti more fëmijën, të trembur në duar, dhe iu drejtove nënës.

Përgjegjësi vuri re se Dini, i pakënaqur, deshi të fliste diçka.

Njëri, gazetari më i ri, ishte pothuajse i panjohur për të.

E hutuar pas studimit, Teuta as që e ktheu kryet.